

VENDIM
Nr. 68, datë 11.4.2022

MBI KËRKESËN E KONCESIONARIT “TEODORI” SHPK, PËR TRANSFERIMIN E PLOTË TË LICENCËS SË SHOQËRISË KONCESIONARE “TEODORI 2003” SHPK, NR. 87, SERIA PV09K, DHËNË PËR VEPRIMTARINË E PRODHIMIT TË ENERGISË ELEKTRIKE NGA HEC “ZALLI I BULQIZËS” DHE HEC “TERNOVË”, TEK SHOQËRIA “TEODORI” SHPK

Në mbështetje të nenit 16, të ligjit nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar; të nenit 10, pika 3, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të Entit Rregullator të Energjisë (ERE) nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, si dhe të nenit 19, pika 1, germa “a”, të “Rregullores për organizimin, funksionimin dhe procedurat e ERE-s”, miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 96, datë 17.6.2016; Bordi i ERE-s, në mbledhjen e tij të datës 11.4.2022, mbasi shqyrtoi relacionin me nr. 434/11 prot., datë 8.4.2022, të Drejtorisë së Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes, “Mbi kërkesën e koncesionarit ‘Teodori’ sh.p.k., për transferimin e plotë të licencës së shoqërisë koncesionare ‘Teodori 2003’ sh.p.k., nr. 87, seria PV09K, dhënë me vendimin e Bordit nr. 83, datë 4.11.2009, për një afat 30-vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC ‘Zalli i Bulqizës’ dhe HEC ‘Ternovë’, tek shoqëria ‘Teodori’ sh.p.k.”,

konstatoi se:

- Shoqëria koncesionare “Teodori” sh.p.k. i është drejtuar ERE-s në cilësinë e Organit Shtetëror të Autorizuar (OSHA), me shkresën nr. 336 prot., datë 2.3.2022, për transferim licence. Në të tilla rrethana, ERE, me shkresën nr. 336/1 prot., datë 18.3.2022, i është përgjigjur shoqërisë duke e sqaruar se Enti Rregullator i Energjisë është autoriteti rregullator i sektorit të energjisë elektrike dhe gazit natyror, i cili funksionon në përputhje me ligjin nr. 43/2015, “Për sektorin e energjisë elektrike”, të ndryshuar. Ndërsa Organi Shtetëror i Autorizuar (OSHA) është Ministria e Infrastrukturës dhe Energjisë, ndaj si e tillë duhet të adresohet saktë kërkesa.

- Në vijim të sa më sipër, shoqëria “Teodori” sh.p.k., me shkresën e protokolluar në ERE me nr. 336/2 prot., datë 24.3.2022, iu drejtua ERE-s në cilësinë e organit publik, i cili ka kompetencë për nxjerrjen dhe transferimin e licencave të prodhimit të energjisë elektrike, duke kërkuar transferimin e licencës së prodhimit të energjisë elektrike tek shoqëria koncesionare “Teodori” sh.p.k., duke parashtruar, ndër të tjera, se ky transferim duhet të bëhet me qëllim që shoqëria “Teodori” sh.p.k. të lidhë kontratën me FTL sh.a., për shitblerjen e energjisë elektrike, me pretendimin se zotëron të drejtat koncesionare.

- Shoqëria “Teodori” sh.p.k., e cila i është drejtuar ERE-s me kërkesën e protokolluar me nr. 336/2 prot., datë 24.3.2022, nuk është në statusin e ortakut që kontrollon interesat e shoqërisë “Teodori 2003” sh.p.k.

- Shoqëria “Teodori 2003” sh.p.k. është mbajtëse e licencës nr. 87, seria PV09K, miratuar me vendimin e Bordit të Komisionerëve të ERE-s nr. 83, datë 4.11.2009, për prodhimin e energjisë elektrike nga HEC “Zalli i Bulqizës” me kapacitet të instaluar 5.350 mw dhe HEC “Ternovë” me kapacitet të instaluar 8.385 mw.

- Referuar nenit 17, pika 1, të “Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike”, të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, përcaktohet se: “Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE dhe/ose me iniciativën e kësaj të fundit, mund

të transferojë plotësisht dhe pjesërisht licencën e një të licencuari në përputhje me ligjin nr. 43/2015, 'Për sektorin e energjisë elektrike'".

- Mbështetur në referencën e sipërcituar, vlerësohet se nuk jemi në asnjë nga rastet e parashikuara në pikën 1, të nenit 17, kjo për arsye se duke marrë parasysh parashikimin: "...Kërkesa për transferimin e licencës bëhet nga i licencuari në ERE...", vlen të theksojmë se nga analizimi i kërkesës së shoqërisë "Teodori" sh.p.k., rezulton se kjo e fundit nuk është shoqëri e licencuar nga ERE, dhe si e tillë nuk legjitimohet për të vijuar më tej me pranimin e kërkesës së saj.

- Po ashtu, edhe sa i përket parashikimit: "...dhe/ose me iniciativën e kësaj të fundit...", pra me iniciativën e ERE-s, nuk jemi në këto kushte pasi nga shoqëria "Teodori" sh.p.k. nuk janë paraqitur rrethana apo fakte që mund të çojnë ERE-n në një vendimmarrje me iniciativën e saj.

- Gjithashtu, nuk jemi as në rastin e parashikuar në pikën 2, të nenit 17, të "Rregullores për procedurat dhe afatet për dhënien, modifikimin, transferimin, rinovimin ose heqjen e licencave në sektorin e energjisë elektrike", të miratuar me vendimin e Bordit të ERE-s nr. 109, datë 29.6.2016, të ndryshuar, i cili citon se: "Ne rastet e transferimit të plotë të asetëve sipas rregullores së miratuar nga ERE për këtë qëllim, personit jo të licencuar tek i cili do të transferohen asetet do t'i transferohet licenca pasi ai të paraqesë një aplikim në ERE për transferimin e licencës duke paraqitur dokumentet...", pasi ERE nuk ka kryer asnjë transferim asetesh të shoqërisë "Teodori 2003" sh.p.k. tek një person jo i licencuar.

Për gjithë sa më sipër, Bordi i ERE-s

VENDOSI:

1. Të mosfillojë procedurën për transferimin e licencës së shoqërisë koncesionare "Teodori 2003" sh.p.k. me nr. 87, seria PV09K, dhënë me vendimin e Bordit nr. 83, datë 4.11.2009, për një afat 30-vjeçar, për veprimtarinë e prodhimit të energjisë elektrike nga HEC "Zalli i Bulqizës" dhe HEC "Tërnovë", tek shoqëria "Teodori" sh.p.k.

2. Drejtoria e Licencimit, Autorizimeve dhe Mbikëqyrjes të njoftojë aplikuesin për vendimin e Bordit të ERE-s.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Çdo palë e përfshirë në këtë procedurë mund t'i kërkojë ERE-s, brenda 7 ditëve kalendarike nga data e marrjes së vendimit, rishikimin e vendimit të Bordit në rast se ka siguruar prova të reja që mund ta çojnë Bordin në marrjen e një vendimi të ndryshëm nga i mëparshmi apo për gabime materiale të konstatuara.

Për këtë vendim mund të bëhet ankim në Gjykatën Administrative Tiranë, brenda 30 ditëve kalendarike nga dita e publikimit në Fletoren Zyrtare.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETAR
Petrit Ahmeti